

Niveli fillestar (A1) Gjuha slovene

Trajnimi dhe provimi

Gjatë programit, do të fitoni njohuri të nivelit fillestar të gjuhës slovene, të cilat janë tejet të rëndësishme për integrimin tuaj në tregun e punës në Slloveni. Përmirësimi i aftësive gjuhësore do të rrisë suksesin e aplikimeve tuaja për punë, do të përmirësojë komunikimin tuaj në jetën e përditshme dhe përfshirjen tuaj në jetën sociale në përgjithësi. Certifikata e marrë për nivelin fillestar (A1) të gjuhës slovene përbën një dokument të vlefshëm, i cili mund të përdoret për qëllime zyrtare ose private.

Për shtetasit e vendeve të treta, kalimi me sukses i provimit të gjuhës slovene brenda një viti nga regjistrimi me Shërbimin e Punësimit të Sllovenisë është i detyrueshëm.

Kush mund të aplikojë për programin:

Ju mund të aplikoni nëse jeni të regjistruar si një **person i papunë** dhe si shtetas i huaj:

- **shtetasit e vendeve të treta:** shtetasve të vendeve të treta u kërkohet të kalojnë provimin e nivelit fillestar (A1) të gjuhës slovene si gjuhë e dytë dhe e huaj **brenda një viti** nga regjistrimi në Shërbimin e Punësimit të Sllovenisë.
- **shtetasit e BE-së:** dhënia e provimit nuk është një kusht për t'u regjistruar si një person i papunë, por marrja e certifikatës do jetë provë që jeni duke kërkuar për punë në mënyrë aktive.

Kujt nuk i kërkohet t'i nënshtrohet provimit të nivelit fillestar:

- nëse keni përfunduar provimin e gjuhës slovene si gjuhë e dytë dhe e huaj të nivelit bazë ose të ndërmjetëm (A2 e lart), ose
- nëse keni ndjekur ndonjë nivel arsimit formal në Slloveni.

Në këtë rast, ju lutemi paraqiteni **dëftesën** tuaj zyrtare të këshilltari juaj personal.

Cfarë do të fitoni nga regjistrimi në program:

- kompetenca gjuhësore (lexim, shkrim, dëgjim dhe të folur në gjuhën slovene në nivelin fillestar (A1)),
- certifikatën e nivelit fillestar (A1) të gjuhës slovene, që përbën një dokument të vlefshëm dhe që mund të përdoret për qëllime zyrtare ose private,
- mundësi më të mira punësimi dhe bashkëpunim më të mirë në vendin e punës,
- kompetencë më të mirë për komunikim në situatat e përditshme dhe në përgjithësi për pjesëmarrjen në shoqëri.

Përmbajtja e programit:

- **TRAJNIMI (një kurs):** Gjuha slovene si gjuhë e dytë dhe e huaj – niveli fillestar (A1). Kohëzgjatja e kursit: 120 - 180 orë.
- **PROVIMI:** Provimi i nivelit fillestar (A1) të gjuhës slovene. Kohëzgjatja: 1 ditë (2 ditë në raste të veçanta). Provimi konsiston në një test leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të foluri në gjuhën slovene.

Programi është **pa pagesë**. Shërbimi i Punësimit të Sllovenisë ju mundëson **pjesëmarrjen një herë në trajnim**

(një kurs) dhe dhënien e provimit një herë. Ndjekja e trajnimit (kursit) nuk është kusht i domosdoshëm për dhënien e provimit. Ju mund të jepni vetëm provimin.

Nëse nuk jeni në gjendje të komunikoni me shkrim dhe nuk keni frekuentuar të paktën 6 klasa të shkollës fillore, mund të jepni provimin vetëm për komunikimin e folur në nivelin fillestar (A1) të gjuhës slovene.

Cfarë do t'ju rimburohet për pjesëmarrjen:

Ne mund t'ju rimburojmë shpenzimet e mëposhtme në bazë mujore për muajin e kaluar:

TRAJNIMI (një kurs):

- **Kompensimi i transportit** – shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje për çdo ditë të pjesëmarrjes tuaj reale në trajnim janë 0,23 Euro për çdo kilometër distancë nga vendbanimi juaj deri në vendin e trajnimit (kur distanca ndërmjet dy vendeve është të paktën 1 kilometër në një drejtim).
- **Kompensimi i aktivitetit** – mbulimi i pjesshëm i kostove të pjesëmarrjes në program, i cili paguhet 1,50 Euro për çdo ditë të pjesëmarrjes tuaj reale në program.

PROVIMI:

- **Kompensimi i transportit** – shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje për çdo ditë të pjesëmarrjes tuaj reale në provim janë 0,23 Euro për çdo kilometër distancë nga vendbanimi juaj deri në vendin e provimit (kur distanca ndërmjet dy vendeve është të paktën 1 kilometër në një drejtim).

